

VENDIM
Nr. 267, datë 21.12.2018

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 19, DATË 19.1.2018
“MBI ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T’U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI TË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR VITIN 2018”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 22, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017 “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, si dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 19, datë 19.1.2018 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2018”,

konstatoi se:

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017 është miratuar “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.

Formula që kjo metodologji përcakton për llogaritjen e këtij çmimi është si më poshtë:

- “Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

VKM-ja e sipërpërmendur në paragrafin 2, pika “ç” dhe pika “d”, përcakton kufijtë minimalë dhe maksimal të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, të cilët janë, çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 (çmim dysHEME) dhe 15% më tepër se ky çmim referues (çmim tavan).

ERE sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, për sa kohë nuk është mbyllur viti ushtrimor 2018, nuk ka mundësinë e axhustimit/korrigjimit të komponentëve të formulës së paraqitur më sipër

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 19, datë 19.1.2018 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018”, ka miratuar çmimin 8.5652 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi vendimin nr. 19, datë 19.1.2018, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018” deri në publikimin e Raportit Vjetor nga HUPEX.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti